



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 169/2014**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Rafet Haxhaj dhe Xhevdet Abazi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega Prizren, paraqitur kundër subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Prizren, për shkak të vendosjes së banorëve mbi rrugë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 08.06.2014, mori këtë:

### **VENDIM**

**Miratohet** si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega Prizren, kështu që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Prizren i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 1550 ( njëmijë e pesëqind e pesëdhjet ) euro të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

### **Arsyetim**

Me datën 05.06.2014, LVV-ja, ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendohet se, rreth orës 14:30 në Prizren, në rrugën “Remzi Ademaj” aktivistët e PDK-së kanë vendosur mbi rrugë publike banerin e kandidatit të tyre për deputet Nait Hasani. Parashtruesi i ankesës me këtë rast thekson se është shkelur neni 4 paragrafi 4.1 pika (b) e Rregullës Zgjedhore nr.11/2013 si dhe neni 3.4 i Rregullës Zgjedhore 13/2014 i Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët. Në cilësi të provës ka bashkangjitur një fotografi si dëshmi .

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it dhe në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika a) të LZP-së me datën 05.06.2014 e informoi subjektin politik PDK për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet në Kërkesë për përgjigje dhe Urdhër për të Ndërramrë Masa Përmirësuese, ndaj ankesës në fjalë deri më datë 06.06.2014 deri në ora 17:00.

PZAP-i, e pranoi përgjigjen në ankesë sipas afatit të caktuar kohor e në të cilin theksohet se baneri në fjalë është larguar nga aktivistët e tyre nga vendi ku ka qenë i vendosur ai dhe brenda afatit të përcaktuar kohor dhe konform nenit 120 të LZP-së janë marrë të gjitha masat përmirësuese në vendin ku pretendohet se ka ndodhur shkelja. Parashtruesi i ankesës në përgjigje në ankesë ka bashkangjitur 3 fotografi si dëshmi nga vendi i ngjarjes duke i larguar banerat ku kanë qenë të vendosura ato.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

## **ankesa është e bazuar**

Nga fotografia e ofruar si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se si baneri me kandidatin për deputet nga radhët e PDK-së Nait Hasani është i vendosur mbi rrugë publike, veprim i cili është në kundërshtim me dispozitën e nenit 33 pika (b) të LZP-së nr.03/L-73, veprime që e bëjnë përgjegjëse subjektin politik PDK e ku dispozitat ligjore të LZP-së përcaktojnë qartë veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore që ndalojnë vendosjen e njoftimeve, pllakateve, posterave dhe slloganeve të ndryshme në lidhje me fushatën zgjedhore në apo mbi rrugët publike.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rëndësuese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rëndësuese mori se subjekti PDK ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se është i njoftuar me dispozitat ligjore dhe me rregullat zgjedhore, si dhe faktin tjetër se baneri i kandidatit për deputet nga ky subjekt politik ka qenë i vendosur mbi rrugë publike si vend i palejuar për vendosjen e tyre. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i, mori se subjekti politik PDK, pas marrjes së kërkesës për përgjigje dhe urdhrin për përmirësimin e shkeljes së pretenduar në ankesë brenda afatit të caktuar, ka ndërmarr veprime të dukshme për evitimin e shkeljes duke e larguar menjëherë banerin nga vendi ku ka ndodhur shkelja dhe ku ka qenë e vendosur ajo.

Andaj PZAP-i duke marrë parasysh të gjitha arsyet e lartcekura se nga ana e subjektit PDK është shkelur neni 33 pika (b) të LZP-së, si dhe duke pasur parasysh veprimet e menjëhershme të PDK-së për evitimin e shkeljes si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura përgjigjes në ankesë e të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar, PZAP-i në kuptim të nenit 120.1 dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 169/2014 më datën 08.06.2014.

**Kryesuesi i Panelit  
Herit Osmani**



#### ***Këshillë Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*